



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 552/ 5 Prot.

Datë 12/03/2026

V E N D I M

Nr. 391/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12/03/2026 me

Objekt:

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-57161-08-05-2025, me objekt: “Projekt i detajuar teknik “Linja hekurudhore Porti Porto Romano -Sukth””, me fond limit 23.682.375 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 243.345,41 (dyqind e dyzet e tre mijë e treqind e dyzet e pesë presje dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 17.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK me NIPT J61811536L dhe adresë: Njësia Bashkiake nr 5, Rruga “Sami Frashëri”, 50 m mbi shkollën “Petro Nini Luarasi” Pallati “Bjorn, Kati 11, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës.
Adresa: Lagja 1, Rruga “Tregtare”, Durrës

Baza Ligjore:

Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766,

datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.08.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-57161-08-05-2025, me objekt: “Projekt i detajuar teknik “Linja hekurudhore Porti Porto Romano -Sukth””, me fond limit 23.682.375 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 243.345,41 (dyqind e dyzet e tre mijë e treqind e dyzet e pesë presje dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 17.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 23.01.2026, ora 10:29:29, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK me numër ankimi elektronik A/2026/6357, datë 23.01.2026 dhe numër protokoli nr. 552/2026, datë 23.01.2026,

ku në seksionin "*Përshkrimi i ankesës*" ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

II.4. Me shkresën nr. 552/1 prot., datë 02.03.2026 me objekt "*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" SHPK*", Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës nr. 552/2026 prot, datë 23.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6357, datë 23.01.2026 të operatorit ekonomik "*ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS*" SHPK të paraqitura pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e rregullimit të të metave të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS*" SHPK, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II.5. Me shkresën nr. 798/1 prot, datës 09.03.2026, me objekt "*Informacion mbi procedurën e Projekt i detajuar teknik "Linja hekurudhore Porti Porto Romano - Sukth"*" protokolluar me tonën me nr. 552/2 prot., datë 11.03.2026, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si më poshtë vijon:

[...] Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, Nr.552/1 prot., datë 02.03.2026, protokolluar në Autoritetit Portual Durrës me Nr. 798 prot., datë 05.03.2026, në të cilin kërkohet informacion i hollësishëm mbi procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur — Mbi kufirin e lartë monetar*", me objekt "*Projekt idetajuar teknik "Linja hekurudhore Porti Porto Romano-Sukth"*", me REF-39100-10-11-2019, ju informojmë se:

Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhërin e prokurimit Nr. 499 Prot., datë 04.08.2025 vendosi nisjen e procedures së prokurimit për kontratën me objekt "*Projekt i detajuar teknik "Linja hekurudhore Porti Porto Romano-Sukth"*",

Më pas u procedua me publikimin në sistemin elektronik të Agjensise së Prokurimit Publik të materialit përkatës.

Me datë 18.08.2025 OE "*ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS*", ka paraqitur ankesë për dokumentat e tenderit..Me IJrdhërin e brendshëm Nr. 2981 Prot..21.08.2025 u procedua me ngritjen e Komsionit e Shqyrtimit të Ankesës

Me shkresën Nr.3033 Prot., datë 29.08.2025 AK i ka kthyer përgjigje OE ankimues duke pranuar ankesën e tij,

Me shkresën nr. 3580/1 Prot, datë 06.10.2025 Autoriteti Portual Durrës ka zbatuar vendimin Nr. 1362/2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, datë 30.09.2025, duke bërë ndryshimet përkatëse në Dokumentat e Tenderit të pasqyruara në një shtojcë, e cila është ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Në vijëmbësi Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 1437/2025 datë 13.10.2025 ka hequr pezullimin e procedurës së prokurimit për shkak të pranimi të ankesës së OE ankimes, si dhe pasqyrimin të ndryshimeve përkatëse me anë të një shtojce ngarkuar në SPE dhe ka autorizuar AK të vijojë me hapat e mëtejshme të parashikuar nga legjislacioni mbi prokurimin publik.

Në orën të datës 17/11 2025, personi përgjegjës për procedurën ka bërë mbylljen në sistemin elektronik të prokurimit të fazës së Dorezimit të Ofertave.

Më pas, çdo anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, hyri individualisht në sistemin elektronik të prokurimit, dhe në dosjen përkatëse të tenderit, klikuan "hap shpallje".

Rezultoi se në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur dokumentacion 4 (katër) operatorë ekonomikë, me ofertat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik BN Projekt NIPT L21305035S nuk ka paraqitur ofertë Ekonomike dhe as dokumentacion.
2. Operatori Ekonomik C.E.C GROUP me NIPT: L11807013M, me ofertë ekonomike në vlerën prej 21,314,137.50 [njëzetë e një milion e treqind e katërmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë presje pesëdhjetë] lekë pa TVSH,
3. Operatori Ekonomik "Gjeokonsult & CO" sh.p.k NIPT: K91810005U, me ofertë ekonomike në vlerën prej 21 077 310 [njëzet e një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dhjetë] lekë pa TVSH,
4. Operatori Ekonomik "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k NIPT: K61814023M, me ofertë ekonomike në vlerën prej 22,500,000. [njëzet e dy milion e pesëqind mijë] Lekë pa tvsh.
5. Operatori Ekonomik BOE "NORD — COMAT" sh.p.k — NUIS: L08501501Q & "Engineering Consulting Group" sh.p.k — NUIS: M0I308013C & "INFRATECH" sh.p.k — NUIS K91628001D, me ofertë ekonomike në vlerën prej 23,682,375 [njëzet e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë] Lekë pa TVSH

1. Operatori Ekonomik BN Projekt NIPT L21305035S nuk ka paraqitur ofertë Ekonomike dhe as dokumentacion justifikues për këtë procedurë prokurimi.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se OE BN Projekt NIPT L21305035S nuk përmbush kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe për rrjedhojë KVO vendosi të mos kualifikoje këtë ofertë.

2. Operatori Ekonomik C.E.C GROUP NIPT: L11807013M, me ofertë ekonomike në vlerën prej 21,314,137.50 [njëzetë e njëmilion e treqind e katërmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë presje pesëdhjetë] lekë pa TVSH,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë mangësitë e mëposhtëme:

OE nuk plotëson pikën 2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale.

Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlere jo me pak se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se punët e ngjashme të paraqitur janë:

- Kontrata “Ndërtimi i Linjës hekurudhore në terminalin perëndimor (Projekt)” për APD- është e vitit 2015. Kjo Kontratë nuk ka vërtetim realizimi.*
- Kontratë shërbimi “Reabilitim operim dhe transferim i rrjetit të transportit hekurudhor në linjat Fier-Ballsh dhe linjat Fier-Vlorë” lidhë me shoqërinë konçesionare "Albrail" është e vitit 2017.*
- Kontratë shërbimi “Reabilitim operim dhe transferim i rrjetit të transportit hekurudhor në linjat Fier-Ballsh dhe linjat Fier-Vlorë” lidhur me shoqëinë konçesionare "Albrail" është e vitit 2018. Objekti i kësaj kontrate është Shërbim Kolaudimi i punimeve për objektin “ Ndërtim i Stacionit të ngarkimit të naftës bruto në fund të stacionit hekurudhor Stacionit trenit Fier-Rafineria Fier”.*

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se OE C.E.C GROUP me NIPT: L11807013M nuk përmbush kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe për rrjedhojë KVO vendosi të mos kualifikojë këtë oferte.

3. Operatori Ekonomik "Gjeokonsult & CO" sh.p.h NIPT: K91810005U, me ofertë ekonomike në vlerën prej 21 077 310 [njëzet e një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dhjetë] lekë pa TVSH,

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë mangësitë e mëposhtëme:

OE nuk plotëson pikën 2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale

Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlere jo me pak se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara ne organet tatimore.

- Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE nuk i ka paraqitur asnjë punë të ngjashme dhe as fatura apo kontrata që të vërtetojnë këtë pikë.*

Mungon ISO 9001-2015 dhe 14001 -2015

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se oferta e OE "Gjeokonsult & CO" sh.p.k NIPT: K91810005U nuk përmbush kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe për rrjedhojë KVO vendosi të mos kualifikojë këtë ofertë.

4. Operatori Ekonomik "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k NIPT: K61814023M, me ofertë ekonomike në vlerën prej 22,500,000. [njëzet e dy milion e pesëqind mijë] Lekë pa tvsh

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ketij OE nuk rezultuan mangësi.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k NIPT K61814023M, i përmbush kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe për rrjedhojë KVO vendosi të kualifikojë këtë ofertë.

5. Operatori Ekonomik BOE "NORD - COMAT" sh.p.k — NUIS: L08501501Q & "Engineering Consulting Group" sh.p.k — NUIS: M01308013C & "INFRATECH" sh.p.k — NUIS K91628001D, me ofertë ekonomike në vlerën prej 23,682,375 [njëzet e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë] Lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ketij OE nuk rezultuan mangësi.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se OE "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k NIPT K61814023M, i përmbush kriteret e kërkuara në Dokumentat e Tenderit dhe për rrjedhojë KVO vendosi të kualifikojë këtë ofertë.

Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertës njoftoi nënpunësin e autorizuar për ndjekjen e kësaj procedure për mbylljen e fazës së vlerësimit.

Me pas u procedua më kërkesën për paraqitje të dokumentacioni nga OE i klasifikuar i pari "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k NIPT K61 814023M, dokumentacioni i cili pasi u verifikua me nga KVO dhe rezultoi në përputhje me origjinalin. Për pasojë u procedua me ngarkimin në SPE të njoftimit fituesit paraprak pas publikimit të secilit më datë (08.01.2026) u hap afati 8 ditore për ankimim.

Më datë 22.01.2026, pra përtej afatit 10 ditore për ankimim dhe ndërkohë që Autoriteti Kontraktor po përpilonte njoftimin e fituesit pas përfundimit të afateve të ankimimit në adresën e personin përgjegjës për ndjekjen e procedurës së prokurimit vjen një email nga adresa email kpp-info@kpp.gov.al me tekstin si më poshtë:

"Përshëndetje

Lidhur me ankesat përkatësisht me nr. Aplikimi A/2026/627 dhe A/2026/6268 lutemi të na bashkëngjisni dokumentet përkatëse për vijuar me publikimin e ankesave."

AK ktheu përgjigje me tekst si më poshtë:

"Përshëndetje,

adresa email të cilës i jeni referuar është ajo e Autoritetit Portual Durrës, Autoritetit Kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Projekt i detajuar teknik "Linja hekurudhore Porti Porto Romano - Sukth".

Për pasojë nuk arrijmë të kuptojmë çfarë dokumentacioni kërkon nga ana jonë në lidhje me publikimin e ankesave. Për më tepër operatori ekonomik ankimues është operatori i klasifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, si dhe lloji i ankesës është për dokumenta tenderi, ndërkohë që procedura ndodhet në tejkalim të afateve të ankimimit pas vlerësimit."

Në vijim më datë 26.02.2026 AK ka rikërkuar informacion në lidhje me statusin e ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, edhe pse ankesa ishte përtej afateve të përcaktuara në legjislacion, e pabazuar në fakte dhe argumenta dhe i referohej një faze tashmë të ezauruar të procedurës për të cilin siç kemi cituar më sipër ishte arritur një vendimmarrje nga AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik. (korrespondenca bashkangjitur).

Për më tepër më datë 26.02.2025 në adresën e personin përgjegjës për ndjekjen e procedurës vjen një email nga OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k NIPT K61814023M, me tekst si më poshtë.

“Përshëndetje,

Ju shkruajmë nga shoqëria **ICE shp.k**, në lidhje me një komunikim të ardhur me email nga KPP (komunikimin e plowte e gjeni më poshtë).

Dëshirojmë t’ju informojmë se shoqëria **ICE sh.p.k** nuk ka kryer asnjë aplikim për ankimim. Vlerësojmë se bëhet fjalë për një gabim të mundshëm të sistemit në platformën e-Albania.

Për këtë arsye, i kemi kthyer përgjigje KPP-së, siç mund ta lexoni edhe më poshtë dhe të njëjtin sqarim dëshirojmë ta bëjmë edhe me ju.”.

Gjendur në këto kushte në datë 26.01.2026 u procedua me ngarkimin e njoftim fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit,, i cili u publikua me datë 27.01.2026.

Më pas u procedua me nënshkrimin e kontratës me objekt “Projekt i detajuar teknik “Linja hekurudhore Porti Porto Romano-Sukth” ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k, Nr. 636 Prot, datë 17.02.2026. si dhe me datë 23.02.2026 u ngarkua në sistem njoftimi i kontratës së nënshkruar.

Me datë 23.02.2026 u evidentua që ishte publikuar në Sistemin online të Komisionit të Prokurimit Publik, një ankesë nga i njëjti OE me të cilin sapo kishim nënshkruar kontratën. “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k, për dokumenta tenderi, fazë e cila tashmë kishte kaluar dhe për të cilën ka patur një vendimmarrje nga AK dhe KPP, me vendimin Nr. 1362/2025, datë 30.09,2025, e cila mungonte në shumë elementë të saj.

OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” sh.p.k, na vuri në dispozicion shkresën më të cilën i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, duke sqaruar se nuk kishte autorizuar apo depozituar pranë KPP-së asnjë ankesë për procedurën e sipërcituar (shkresa bashkangjitur)

Për sa shtjelluar më sipër, Autoriteti Portual Durrës nuk ka iniciuar asnjë proces për plotësimin e mangësive të ankesës paraqitur nga OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” shpk, Nr. 552/2026, datë 23.01.2026, e cila përtej faktit që nuk ka asnjë bazë ligjore, procedurale dhe llogjike, është kundërshtuar në paraqitjen e saj nga vetë OE ankimues “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” shpk. Për rrjedhojë ankesa konsiderohet e paparaqitur.”.

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.I. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 23.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, me numër ankimi elektronik A/2026/6357, datë 23.01.2026 dhe numër protokolli nr. 552/2026, datë 23.01.2026 të operatorit ekonomik “*ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS*” SHPK, ku kërkon modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me numër reference Nr. REF-57161-08-05-2025, me objekt: “*Projekt i detajuar teknik “Linja hekurudhore Porti Porto Romano -Sukth”*”, me fond limit 23.682.375 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 243.345,41 (dyqind e dyzet e tre mijë e treqind e dyzet e pesë presje dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 17.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 22.01.2026, ora 10:29:29, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “*ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS*” SHPK me numër ankimi elektronik A/2026/6267, datë 22.01.2026 dhe numër protokolli nr. 193/2026, datë 22.01.2026, ku në seksionin “*Përshkrimi i ankesës*” ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Në datën 23.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “*ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS*” SHPK me numër ankimi elektronik A/2026/6357, datë 23.01.2026 dhe numër protokolli nr. 552/2026, datë 23.01.2026, ku në seksionin “*Përshkrimi i ankesës*” ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës)

III.1.4. Neni 24, pika 1, “*Komisioni i Prokurimit Publik*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij*”.

III.1.5. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” i Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.6 Në nenin 111, pika 1 e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.*

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.”*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”

Neni 115, pika 1 dhe 3 i Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe*

vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë: a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin: i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar; 70 ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik: a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji; b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. i ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar. Në rastin konkret, rezulton, se publikimi i njoftimit të kontratës së procedurës së prokurimit objekt ankimi është kryer në datën 06.08.2025 në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE). Ndërkohë ankesa e operatorit ekonomik ankimues “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi më datë 23.01.2026, me numër ankimi elektronik A/2026/6357, datë 23.01.2026 dhe numër protokolli nr. 552/2026, datë 23.01.2026, jashtë afateve ligjore të ankimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e mësipërme e operatorit ekonomik “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110 pika 1 e LPP, i cili parashikon se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”..

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe përfundon në ditën e 7-të në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar ose ditën e 10-të në rastin e procedurave të prokurimit nën kufirin e lartë monetar. Në rastin konkret data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është **06.08.2025**, ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së është e datës **23.01.2026**, datë e cila rezulton të jetë jashtë afatit 10-të ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë **23.01.2026**, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit sipas parashikimeve të LPP, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS*” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*” me numër reference Nr. REF-57161-08-05-2025, me objekt: “*Projekt i detajuar teknik “Linja hekurudhore Porti Porto Romano -Sukth”*”, me fond limit 23.682.375 (njëzet e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 243.345,41 (dyqind e dyzet e tre mijë e treqind e dyzet e pesë presje dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 17.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
KreshnikTernova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

